

● BREAKING NEWS

MË NË FUND LAJME TË MIRA NGA INFEKTIVI! JA ÇFARË NDODHI NË 24 ORËT E FUNDIT



AKTUALITET

Atentat me armë zjarri në Peqin, ekzekutohet me breshëri plumbash 35-vjeçari, autorët djegin makinën dhe arratisen

SHKRUAR NGA DENISA IBRAHIMI
28 DHJETOR 2021




Mëngjesin e djeshëm, në fshatin Gjoçaj të Peqinit është ekzekutuar me breshëri plumbash 35-vjeçari Albi Bashaliu. Viktima ka qenë duke shkuar në lokalin e lagjes, teksa sapo ka zbritur nga makina e tij, është qëlluar me armë zjarri pistoletë me disa plumba. Në vendngjarje nga grupi hetimor u gjetën gëzhoja plumbash dhe u morën në pyetje dëshmitarët. Nga deklarinimet e tyre u zbulua se ishin dy persona që qëlluan ndaj Bashaliut, të veshur me të zeza dhe me maska anti-COVID. Njëri prej dëshmitarëve tregoi se pasi qëlluan dy herë ndaj viktimës, atentatorët e kontrolluan nëse ai kishte vdekur dhe më pas kanë qëlluar dhe dy herë të tjera ndaj tij. Më pas vrasësit janë larguar me makinën e Bashaliut nga vendngjarja. Ndërsa makinës me të cilën kishin shkuar për të ekzekutuar viktimën, para se të largoheshin atentatorët e kanë djegur. Fakti që dy atentatorët janë larguar nga vendngjarja me makinën e viktimës, dyshohet se mund të ketë ndodhur për shkak se janë braktisur nga bashkëpunëtorët e tyre për t'i larguar nga vendngjarja. Një tjetër pistë është defekti që mund të ketë ndodhur me automjetin të cilin e dogjën, pasi dyshohet se pasi kanë qëlluar ndaj Bashaliut ata janë afruar te automjeti i tyre. Më pas kanë shkuar i kanë marrë çelësat e makinës viktimës. Pas vrasjes, grupi hetimor ka shkuar në vendngjarje dhe u bë krehja e zonës për identifikimin dhe kapjen e autorëve. Në vendngjarje po ashtu ka shkuar dhe drejtori i Policisë Kriminale, Tonin Vocaj. Për kapjen e autorëve, nga ana e policisë po kryhen dhe kërkime me helikopter. Në lidhje me vrasjen e 35-vjeçarit Albi Bashaliu, janë marrë në pyetje nga policia disa persona.


Dyshimet për hakmarrje

Pista kryesore ku po hetohet ekzekutimi i Albi Bashaliut është ajo e hakmarrjes. Vëllai i viktimës, L.Bashaliu aktualisht ndodhet në qeli pasi 6 muaj më parë ky i fundit ka vrarë Ylber Xhahysën. Konflikti mes L.Bashaliut dhe Xhahysës kishte nisur 5 vite më parë, pasi viktima Xhahysa i kishte gërvishur makinën Bashaliut. Pas këtij konflikti të nisur vite më parë, në qershor të këtij viti Ylber Xhahysa mbeti i vrarë. Viktima Xhahysa dhe autori, i cili vuan dënimin tashmë, fillimisht janë konfliktuar verbalisht. Më pas konflikti ka degraduar në përdorimin e armës nga ana e Bashaliut. Ylber Xhahysa u dërgua me shenja jete në spital, por ndërroi jetë si pasojë e plagëve. Pasi vrau Xhahysën autori tentoi të arratisesh, por u kap nga policia. Në dëshminë e tij pas ngjarjes, L.Bashaliu u shpreh se e vrau pasi viktime e kishte ofenduar dhe e kishte rrahur. Viktima e ditës së djeshme, Albi Bashaliu u vra në afërsi të vendit ku vëllai i tij vrau Ylber Xhahysën në qershor të këtij viti. Mes personave të marrë në pyetje nga policia në lidhje me vrasjen e 35-vjeçarit Bashaliu, kanë qenë dhe anëtarë të familjes Xhahysa, me të cilët familja e tij ishte në hasmëri. 35-vjeçari i vrarë mëngjesin e së djeshmes ka qenë një emër i njohur për policinë. Në 2017 Albi Bashaliu është arrestuar pasi u akuzua për atentat ndaj dy personave, pasi kishte qëlluar me automatik ndaj tyre. Dy personat ndaj të cilëve qëllloi Albi Bashaliu, shpëtuan pa lëndime.


Më të lexuarat




Përplasen 2 makina në Lushnje, raportohet për tre të plagosur




Muzikë pas orës 23:00 dhe minorenë në lokal, procedohet penalisht administratori në Tiranë




Policia e Shtetit bën bilancin e ditëve të festave: Nuk u shënua asnjë ngjarje kriminale dhe asnjë aksident me vdekje




Omicron, konfirmimi nga gjashtë studime shkencore, ja cila pjesë e trupit preket dhe pse është më ngjitëse




Nuk shënohet asnjë vdekje Covid në Kosovë, ja sa raste të reja janë regjistruar në 24 orët e fundit




Parakalim i gabuar, "Golfi" goditet nga një makinë dhe del jashtë rruge




Kosova shpalli "non grata" zyrtarin rus, reagon OKB: Vendim i pazbatueshëm




Kokaina e kapur në Vaqarr, lihet në burg administratori dhe shoferët e firmës së bananeve




Lajm i trishtë/ Ndërron jetë ish-luftëtari i UÇK-së



Shkoi për të peshkuar por nuk u kthye më në shtëpi, ende asnjë gjurmë nga 43-vjeçari



Tani e kuptoj pse mjekët ikin në Gjermani", pedagogu i njohur nxjerr pagat marramendëse, shihni sa paguhet një shofer tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit



Merrte vajzat shqiptare dhe i dërgonte për prostitucion, 51-vjeçari ekstradohet nga Italia drejt Shqipërisë

Mesazhe Promocionale

Gossip




■ ■ ■ ■ ■ ■

Sabiani dërgon vajzën e Ilirit në aeroport: E përcollëm motrën!


Iliri dhe Sabiani kanë treguar një shoqëri të madhe me njëseu...

Opinione




SKËNDER SADRI KAPITI

Parlamenti të miratojë ligjin për përjashtimin ...




YLLI MEÇE

"Eko grafia" e një sistemi katërcipërisht të de...



FATOS ÇOÇOLI DHE NATALIA YMERAJ

Flini me ëndrra dhe zgjohuni me qëllime!



BESI BEKTESHI

Iluzionisti demokracisë i së "bukurës së dheut"...

LEXO OPINIONE TE TJERA

Sponsored Stories

Rama zihet keq me komentuesin, ja debati i ashpër dhe leksionet që i jep i riu për gjuhën shqipe
sot.com.al

"Ai merrte 2 miliardë dollarë në vit nën tavolinë nga SHBA", Spartak Ngjela nxjerr prapaskenat dhe lëshon paralajmërimin ...
sot.com.al

Po kryenin punime në shtratin e lumit Gjanica në Fier, punonjësit befasohen nga ajo çfarë gjejnë (FOTO)
sot.com.al

Recommended by outbrain